



**Support to the Employment of Young People,
Long-Term Unemployed and Women (II)**
This project is funded by the European Union



Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, në suaza të jetësimit ekzistues të projektit “Mbështetja për punësimin e të rinjve, të papunëve afatgjatë dhe grave” (II) të financuar nga BE-ja, bën:

SHPALLJE PUBLIKE

për personat e regjistruar si të papunë të cilët janë të interesuar të marrin pjesë në stërvitjet për aftësi të përgjithshme (Stërvitje për gjuhë të huaja dhe për aftësi themelore kompjuterike)

Stërvitjet për aftësi të përgjithshme (Stërvitjet për gjuhë të huaja dhe aftësi themelore kompjuterike) do të mbahen në periudhën prej dy deri katër muaj nga ana e provajderëve stërvitës, të zgjedhur nga APRM-ja, në mbarë territorin e shtetit.

Stërvitjet do të organizohen me qëllim që t’u ndihmojë personave të papunë të fitojnë aftësi të përgjithshme të cilat do t’u ndihmojnë për t’i përmirësuar komponentet e tyre dhe më lehtë të përfshihen në tregun e punës.

Procedura e aplikimit

Të gjithë personat e papunë që janë të regjistruar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv të punës, të cilët janë të interesuar për pjesëmarrje në këto stërvitje, mund të plotësojnë aplikacionin e pjesëmarrjes në qendrat vendore të qendrave të punësimit, për njërin nga stërvitjet siç vijojnë:

Lloji i stërvitjes	Kohëzgjatja e stërvitjes	Cili mund të paraqitet në stërvitje	Përfaqësimi regional i pjesëmarrësve në stërvitje
Stërvitje për gjuhë të huaja: Anglisht, gjermanisht, italisht, turqisht, greqisht, frëngjisht, spanjisht dhe shqip (niveli fillestar dhe avancues)	48 orë	Përafërsisht 550 persona të papunë të regjistruar si kërkues aktiv të punës	Regjioni i Vardarit: Veles, Kavadar, Negotinë dhe Shën Nikollë (100 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni Lindor: Berovë, Vinicë, Dellçevë, Koçanë, Probishtip dhe Shtip (100 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni Jugperëndimor: Dibër, Kërçovë, Makedonski Brod, Strugë dhe Ohër (100 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni Juglindor: Vallandovë, Gjevgjeli, Radovish dhe Strumicë (50 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni i Pollogut: Gostivar dhe Tetovë (100 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni Verilindor: Kratovë, Kriva Pallankë dhe Kumanovë (100 pjesëmarrës në stërvitje);
Aftësi themelore kompjuterike: Ëord processing programs (p.sh. MS Ëord); Spreadsheet softëare	48 orë	Përafërsisht 1000 persona të papunë të regjistruar si kërkues	Regjioni i Vardarit: Veles, Kavadar, Negotinë dhe Shën Nikollë (100 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni Lindor: Berovë, Vinicë, Dellçevë, Koçanë, Probishtip dhe Shtip (100 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni Jugperëndimor: Dibër, Kërçovë,





**Support to the Employment of Young People,
Long-Term Unemployed and Women (II)**
This project is funded by the European Union



(p.sh. Excel); Database management softëare (p.sh. MS Access); Project management softëare (p.sh. MS Project) dhe internet;		aktiv të punës	Makedonski Brod, Strugë dhe Ohër (100 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni Juglindor: Vallandovë, Gjevgjeli, Radovish dhe Strumicë (50 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni i Pollogut: Gostivar dhe Tetovë (100 pjesëmarrës në stërvitje); Regjioni Verilindor: Kratovë, Kriva Pallankë dhe Kumanovë (100 pjesëmarrës në stërvitje);
---	--	----------------	---

Aplikimi për pjesëmarrje në stërvitje përmban informata themelore për kandidatin, si dhe stërvitjen për të cilën ai aplikon.

Të gjithë personat e papunë të cilët janë të interesuar dhe që janë regjistruar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv të punës, do të përzgjidhen në përputhje me planin e tyre individual të punësimit.

Përzgjedhja përfundimtare e pjesëmarrësve në stërvitje do të bëhet nga ana e Komisionit të Evoluimit sipas kriterëve siç vijojnë:

- Personi i papunë të jetë i regjistruar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv i punës dhe
- Personi i papunë në planin individual të punësimit të deklarojë se dëshiron ta ndjekë stërvitjen e aftësive të përgjithshme.

Në qoftë se numri i të interesuarve për pjesëmarrje në këto stërvitje në disa regjione e tejkalon numrin e planifikuar të pjesëmarrësve në stërvitje, përparësi do t'u jepet personave siç vijojnë:

- personave të papunë të cilët janë të profilizuar si drejtpërdrejt të punësueshëm, përkatësisht personave me arsimim të lartë dhe personave të cilët tanimë kanë fituar aftësi dhe shkathtësi të tjera të cilat do t'i ndihmonin të gjejnë punë me ndihmën minimale nga ana e Agjencisë së Punësimit, siç janë stërvitjet për aftësi të përgjithshme.

Kandidatët e zgjedhur do të nënshkruajnë marrëveshje për pjesëmarrje në këtë stërvitje. Pjesëmarrësit e stërvitjes (personat e papunë) të cilët do ta mbarojnë me sukses, do të marrin certifikatën e pjesëmarrjes në stërvitje.

Afati i fundit i aplikimit

Personat e papunë të cilët janë të interesuar mund të dorëzojnë aplikimet e tyre të pjesëmarrjes në një stërvitje sipas cikleve në APRM dhe 30 qendrat e punësimit në mbarë shtetin, çdo ditë prej orës 8:30 deri 16:30 minuta.

Aplikimet e pjesëmarrësve do të evoluohen para fillimit të stërvitjes mesatarisht një herë në çdo katër muaj nga dita e botimit të kësaj shpalljeje.

Projekti „Mbështetja për punësimin e të rinjve, të papunëve afatgjatë dhe grave” (II) është financuar në suaza të programit operativ për “Zhvillimin e burimeve njerëzore 2007-2013” (IPA Komponenti IV). Aktivitetet e projektit ndihmojë drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve nga Plani operativ i masave aktive në tregun e punës për vitin 2015.

Shpallja publike është botuar edhe në ueb faqet siç vijojnë:

- Agjencia e Punësimit: www.avrm.gov.mk.
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale: www.mtsp.gov.mk.

